



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 04, datë 22.01.2021

PËR
AKREDITIMIN E PARË TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË
MASTER PROFESIONAL NË “DREJTIM I NDËRMARRJEVE TURISTIKE”, TË
UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 11.9.2018, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 1, datë 07.04.2017, “Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit” dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 22.01.2021, në kuadër të vendimarrjes për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në **“Drejtim i Ndërmarrjeve Turistike”**, me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Master Profesional në **“Drejtim i Ndërmarrjeve Turistike”**
- b) Cikli i studimit: Cikli i dytë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Urdhër i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr.655, datë 11.10.2018
- d) Institucioni që e ofron: Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
- e) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Turizmit
- f) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 1 vit / 2 semestra
- g) Kredite (ECTS): 60 kredite
- h) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- i) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
- j) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 7

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Raportimin e Ekspertëve të Vlerësimit në mbledhjen e Bordit;
- e. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- f. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- g. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuar e verifikuara përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësimin të *“Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional”* dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit është **“i përmbush pjesërisht standardet”**, me mangësitë si më poshtë:

1. Në këtë program studimi janë angazhuar si lektorë staf akademik pa gradë shkencore në mospërmbushje të akteve ligjore dhe nënligjore.
2. Jo të gjithë titullarët e lëndëve/moduleve mbajnë titullin përkatës akademik sipas përcaktimeve në aktet ligjore përkatëse.
3. Në disa raste fusha e ekspertizës e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi nuk përputhet me lëndët që ata mbulojnë në këtë program.
4. Programi i studimit ka probleme strukturore dhe përmbajtësore të cilat nuk kontribuojnë në formimin me njohuri dhe aftësim të studentëve.
5. Literatura e përdorur për këtë program studimi jo në të gjitha rastet, përfshin tituj të 5 viteve të fundit.
6. Emërtimi i programit të studimit në gjuhën angleze në suplementin e diplomës, *“Tourist Entreprises Direction”*, nuk është korrekt dhe i përfruar me atë çka ofrojnë diplomat e fushës në botë, duke vështirësuar kështu edhe njohjen në nivele ndërkombëtare.
7. Mungon një studim i mirëfilltë i tregut të punës ku të analizohen dhe reflektohen nevojat reale të këtij programi studimi, në tregun e punës.

8. Mungesa e sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit për këtë program studimi.
9. Mungesa e marrëveshjeve të bashkëpunimit apo qoftë edhe komunikim zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve etj.
10. Mungesa e trajnimeve, praktikave apo eksperiencave në njësi hoteliere apo operator turistik.
11. Studentët nuk janë të orientuar për të kryer diplomat e tyre drejt nevojave reale të tregut të punës me të cilat përballen ndërmarrjet turistike.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,

VENDOSI:

1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit **Master Profesional** në **“Drejtimit i Ndërmarrjeve Turistike”**, të **Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës**, me rekomandimet sipas shtojcës së këtij vendimi.
2. **Akreditimin** e programit të studimit **vetëm për studentët e regjistruar deri në vitin akademik 2020 – 2021 dhe që aktualisht ndjekin këtë program studimi deri në diplomimin e tyre**. Institucioni të mos pranojë e regjistrojë më studentë të rinj në këtë program studimi deri në riorganizimin e tij në masën mbi 20 %, në përmbushje të mangësive të pikës **“e”** të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve Shtetërore të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


BORDI I AKREDITIMIT

ARJAN GJONÇA



Kryetar

ALEXANDER KOHLER



Anëtar

FABRICE HENARD



Anëtar

| | | |
|--------------------|---|--------|
| ARBEN MERKOCI |  | Anëtar |
| ALEKSANDËR XHUVANI |  | Anëtar |
| ANILA PAPARISTO |  | Anëtar |
| SULO HADERI | | Anëtar |
| LULJETA MINXHOZI |  | Anëtar |
| GËZIM VISOKA |  | Anëtar |
| DRINI IMAMI |  | Anëtar |
| FATMIR GURI |  | Anëtar |

Z. S.Haderi nuk morri pjesë në këtë mbledhje

Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 04, datë 22.01.2021, “Për akreditimin e parë të programit të studimit **Master Profesional në “Drejtim i Ndërmarrjeve Turistike”**”, të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, janë si vijon:

1. Institucioni, të rrisë mbështetjen e tij për zhvillimin e kualifikimin akademik të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi dhe rritjen e numrit të tij me specialistë të kësaj fushe specifike.
2. Institucioni, të angazhojë si titullarë të lëndëve/moduleve të programit të studimit, pedagogë që mbajnë titullin përkatës, sipas përcaktimeve në aktet ligjore përkatëse.
3. Institucioni të realizojë:
 - përmirësime cilësore të strukturës së programit;
 - të përmbajtjes së çdo syllabusi;
 - verifikime dhe të sigurohet që të mos ketë mbivendosje konceptesh;
 - konsultime me ekspertë të fushës, akademikë, drejtues të ndërmarrjeve turistike të zonës, me të gjithë aktorët dhe faktorët që ndikojnë në zinxhirin e vlerës;
 - pyetësorë për të marrë dhe reflektuar feedback-un e studentëve dhe stafit mësimdhënës;
4. Institucioni, të përditësojë literaturën e përdorur për këtë program studimi duke përfshirë tituj të paktën të 5 viteve të fundit.
5. Institucioni, të korrigjojë emërtimi e programi të studimit dhe suplementin e diplomës në gjuhën angleze, për ta përafuar atë me atë që ofrojnë diplomat e kësaj fushe në botë.
6. Institucioni, të kryejë një studim të mirëfilltë të tregut të punës në të cilin të reflektojë me evidencën nevojat reale të tregut të punës për këtë program studimi.
7. Institucioni, të marrë masa për përdorimit e sistemeve të brendshme të menaxhimit të informacionit, për komunikim, shpërndarje informacioni etj.
8. Institucioni, të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me strukturat drejtuese në njësitë vendore dhe/ose qendrore si edhe rajonal e më gjerë, për studime, internshipe, trajnime të vazhduara, në mënyrë që të përafrohet më mirë kërkesa me ofertën për administratorët publikë të turizmit.
9. Institucioni, të realizojë trajnime, praktika apo eksperiencë me njësi hotelerie apo operatorë turistik për të aplikuar njohuritë teorike të fituara, në praktikë.
10. Institucioni, të hartojë mekanizma me qëllim orientimin e studentëve drejt kryerjes së temave të diplomave që lidhen me nevojat reale të tregut të punës dhe problematikave që përballen ndërmarrjet turistike.

Rekomandimet si më lart duhe të mbahen parasysh nga institucioni edhe gjatë procesit të riorganizimit të këtij programi studimi sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi

